



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr 2156/2 prot

Gramsh 05/06/2024

**V E N D I M**

Nr 38 dt. 31.05 .2024

**PER**

**“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË PARË TË PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMESËM 2025-2027 PER BASHKINË GRAMSH”**

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 31 .05 .2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja “c”, neni 41 pika 1, neni 54 shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar; neni 36 të ligjit nr. 68/2017 ”Për financat e veteqeverisjes vendore”; ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar; Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”, Udhëzim plotësues nr. 03 datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027” me shtojcat plotësuese, si dhe materialin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Gramsh ;

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë projektin e parë të Programit Buxhetor Afatmesem për vitet 2025 – 2027, të Bashkisë Gramsh sipas relacionit shpjegues për procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (Shtojca 2, Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027) bashkelidhur dhe formateve të FPT bashkelidhur si me poshte :

*Tabela 1. Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë GRAMSH*

*Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit*

*Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike*

*Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike*

*Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike*

*Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit*

*Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit*

*Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit*

*Tabela 9. Të dhënat e Programit*

2-Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetar i Bashkise dhe aparati i Bashkise.

3-Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

Kryetari i Keshillit te Bashkise  
Enis Zati





2156/3

13.06.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 057/1 Prot

Elbasan, më 12.6.2024

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË GRAMSH**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.38, datë 31.05.2024 " Për miratimin e Projektit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Gramsh", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**NËNPREFEKTI I GRAMSHIT**

Albert CECI

